L I G J
Nr. 8952, datë 10.10.2002

PËR DOKUMENTIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj përcakton dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë, me qëllim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një dokument identifikues unik, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij dokumenti.

Neni 2

1. Dokumenti i identitetit të personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë. Ky dokument lëshohet nga zyra e gjendjes civile, në regjistrin themeltar të së cilës është regjistruar shtetasi.
2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete dokumentin e identitetit.

Neni 3

1. Për pajisjen me dokument identiteti shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
a) të jetë i regjistruar në regjistrin themeltar dhe të jetë banor i njësisë vendore, që ka në juridiksion zyra e gjendjes civile, e cila e lëshon këtë dokument;
b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.
2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me dokument identiteti, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Dokumenti i identitetit mund të lëshohet me ose pa afat.
Dokumenti i identitetit lëshohet me afat për shtetasit me moshë nga 16 deri në 30 vjeç. Pavarësisht nga kjo, dokumenti i identitetit ka afat të paktën 5 vjet nga data e lëshimit.
Dokumenti i identitetit lëshohet pa afat për shtetasit mbi 30 vjeç.

Neni 5

Shtetasi pajiset me dokument të ri identiteti kur:
plotëson kushtet e nenit 3 pika 1 të këtij ligji;
b) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në dokumentin e identitetit, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
c) vërtetohet nga organet përkatëse se dokumenti i identitetit i ka humbur ose i është vjedhur.

Neni 6

Dokumenti i identitetit është një kartë plastike, në të cilën janë pasqyruar qartë dhe shënuar

me metoda informatike:

a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, emri, mbiemri, atësia, amësia, datëlindja dhe vendlindja;

b) fotografia e shtetasit, mbajtës i këtij dokumenti;

numri i identitetit të shtetasit;

ç) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;

d) elemente sigurie brenda normave të Komunitetit Europian, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë. Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Neni 8

Forma, modeli i dokumentit të identitetit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr.4172, datë 13.9.1966 “Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim”, ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3542, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu